

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta
Drejtoria e Monitorimit të Strategjive Ndërsektorale

Nr 2328/2

Tiranë, më 20.2.2009

Lënda: Kthim përgjigje për Raportin e veçantë Nr 3 të institucionit të Avokatit të Popullit

Drejtuar: Z.Ermir Dobjani
Avokati i Popullit

Në përgjigje të shkresës tuaj Nr 29/1 Prot, datë 30.01.2009, lidhur me informacionin e Ministrisë së Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për çështjet e shtruara në raportin nr 3 të institucionit tuaj sqarojmë:

Pas shqyrtimit të raportit vlerësojmë se materiali jep informacion mbi veprimtarinë e institucionit të Avokatit të Popullit në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve. Në shkresën tuaj, theksohet se ky raport adreson çështje apo rekomandime të drejtpërdrejta për Ministrinë e Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, të cilat nuk i konstatojmë në dokument

Megjithatë, në kuadër të bashkëpunimit për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve, bashkëlidhur po ju dërgojmë raportin vjetor për zbatimin e objektivave të Strategjisë Kombëtare për Fëmijë 2005-2010, për periudhën qërshor 2007-maj 2008. Ky raport është përgatitur nga Sekretariati Teknik për Fëmijë, bazuar në informacionet e mbledhura nga institucionet në nivel qëndror e vendor nga shoqëria civile.

Bashkëlidhur do të gjeni raportin vjetor që u lançua edhe në konferencën kombëtare për fëmijë në qërshor 2008.

MINISTRI

Anastas DURO